



Kosovo Career
Development Foundation



BAROMETRI I ORIENTIMIT TË MATURANTËVE NË KARRIERË DHE NDËRMARRËSISË

Hulumtim me maturantë mbi përgatitjen dhe planet e tyre pas diplomimit



KOMUNA E PEJËS

NËNTOR 2020

Barometri i Orientimit në Karrierë

Autore:

Mirjeta Nagavci

Realizimit të këtij hulumtimi i kontribuan:

Nga KCDF: Aurel Haxhiu, Ermira Berisha, Flandra Sadiku, Mirjeta Nagavci, Shkumbin Emrullahu, Vesa Hoxha.

Nga shkollat pjesëmarrëse: Arben Gjokolli, Mustafë Ukaj, Bujar Kelmendi, Besmir Nikqi, Zamirë Selimi, Arif Ademaj, Anda Ethem i dhe gjithë nxënësit pjesëmarrës.

Mbështetur nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Pejës.

© Solidar Suisse, Pejë, Nëntor 2020.

© Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës, Prishtinë, Nëntor 2020.

www.solidar-suisse-kos.org
info@solidar-suisse-kos.org
+383-39-421-411

www.koscdf.org
info@koscdf.org
+383-44-507-575

Përmbajtja

HYRJE	4
RRETH FONDACIONIT KOSOVAR PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS (KCDF)	4
BAROMETRI I ORIENTIMIT NË KARRIERË DHE NDËRMARRËSISË	5
FJALA E DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT	5
MIRËNJOHJE	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	6
DIZAJNI I HULUMTIMIT	6
INSTRUMENTI	6
PROCEDURA E ANKETIMIT DHE ÇËSHTJET ETIKE	6
MOSTRA	6
ANALIZIMI I TË DHËNAVE	8
REZULTATET	8
PLANET PROFESIONALE DHE EDUKATIVE TË MATURANTËVE PAS KLASËS SË XII-TË	8
PUNA PRAKTIKE GJATË SHKOLLËS SË MESME TË LARTË	12
MBËSHTETJA RRETH ORIENTIMIT NË KARRIERË DHE QASJA NË TREG TË PUNËS	14
DISKUTIM	19
SHTOJCA	21
SHTOJCA 1. NDËRLIDHJA MES PROFILEVE AKTUALE DHE FUSHAVE TË STUDIMIT PËR SECILËN SHKOLLË.	21
SHTOJCA 2. VENDOSMËRIA E NXËNËSVE PËR FUSHËN E STUDIMIT PËR SECILËN SHKOLLË.	23
SHTOJCA 3. MESATARJA E ORËVE PRAKTIKE VARËSISHT PROFILIT PËR SECILËN SHKOLLË.	24
SHTOJCA 4. PAJTUESHMËRIA ME KONSTRUKTIN PËR PËRGATITJE TË APLIKACIONIT PËR PUNË PËR SECILËN SHKOLLË.	26
SHTOJCA 5. PAJTUESHMËRIA ME KONSTRUKTIN PËR NDIHMËN E SHKOLLËS RRETH ORIENTIMIT NË KARRIERË PËR SECILËN SHKOLLË.	27

Hyrje

Rreth Fondacionit Kosovar për Zhvillim të Karrierës (KCDF)

Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (Kosovo Career Development Foundation – KCDF) është organizatë joqeveritare që synon promovimin e aktiviteteve të ndërlidhura me orientimin në karrierë, ndërmarrësin dhe përafrimin në mes të sistemit të arsimit dhe tregut të punës. Për të përmbushur qëllimet e saj, KCDF realizon projekte dhe aktivitete të fushë-veprimtarisë Edukim/Trajnim, Hulumtime dhe analiza dhe Punësim. Për më shumë, KCDF ka rolin e trupit ndërmjetësues dhe koordinues mes akterëve të përfshirë në fushën e orientimit në karrierë. Në aktivitetet e saj, KCDF siguron bashkëpunim me dhe mes institucioneve publike, organizatave joqeveritare, sektorit privat, prindërve, etj.

Konkretisht, KCDF është e përfshirë në një sërë projektesh. KCDF administron sistemin informues nacional për orientim në karrierë – Busulla.COM. Ky sistem është themeluar në vitin 2017 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për t'i siguruar çdo shkollë publike në vend qasje në një platformë gjithëpërfshirëse për edukim dhe orientim në karrierë. Busulla.COM numëron mbi 250,000 përdorues për të cilët KCDF sigurohet të ofrojë mbështetje dhe informata të përditësuara dhe relevante.

Tutje, KCDF në mbështetjen e programit GIZ CDBE ka ngritur dhe mbështet Klubet e Karrierës në 20 shkolla të mesme të ulëta të Kosovës. Përmes Klubeve të Karrierës synojmë rritjen e cilësisë në shkollë, fuqizimin e nxënësve dhe zhvillimin e shkathtësive të tyre të menaxhimit të karrierës dhe shkathtësive të buta dhe teknike.

Për më tepër, KCDF përkrah nxënësit e klasave të IX-ta të shkollave të Komunës së Pejës rreth orientimit në karrierë. Me mbështetje të Komunës së Pejës dhe Solidar Suisse, KCDF zbaton projektin “Lehtësimi i tranzicionit të nxënësve nga SHMU në SHML”. Ky projekt përmban aktivitete të ndryshme një viti shkollor përgjatë që synojnë pjekurinë profesionale të nxënësve në njërin anë dhe promovimin e mundësive edukative në anën tjetër.

Përveç këtyre, KCDF shërben si zyre koordinuese për Klubet e Karrierës dhe Qendrat e Karrierës, e cila punon për së afërmi me programe të ndryshme, siç janë Programi Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt (anglisht: ASSET) nga USAID, asociacioni Gjerman për bashkëpunim ndërkombëtar – GIZ dhe Projekti Rritja e punësimit për të rinjtë (anglisht EYE) nga organizata HELVETAS. Përmes këtyre iniciativave të përbashkëta të organizatave dhe shkollave synohet ndërlidhja në mes të shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta si dhe ndërlidhja e shkollave me tregun e punës.

Për të përmbushur qëllimet dhe në linjë me veprimtarinë e saj, KCDF zbaton në nivel vendi edhe hulumtimin “Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë”. Ky hulumtim zbatohet për herë të parë me maturantët e vitit shkollor 2019/2020 të shkollave profesionale dhe planifikohet të zbatohet me maturantët e çdo viti shkollor në të ardhmen.

Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë

“Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë” ka për qëllim të mbështes politik-bërjen dhe zbatimin e praktikave relevante duke ofruar informata mbi perspektivën dhe nevojat e maturantëve kosovar rreth përgatitjes dhe të ardhmes së tyre edukative e profesionale. Më specifikisht, hulumtimi vlerëson dhe raporton mbi planet e maturantëve për studime apo punësim dhe perceptimin e tyre mbi kontributin e shkollës dhe burimeve tjera në përgatitje profesionale. Fokus primar janë maturantët nga shkollat profesionale. Të gjeturat nga ky hulumtim informojnë institucionet përkatëse të përfshira në edukim dhe punësim, si MASH, MPMS, DKA, shkollat përkatëse, bizneset, prindërit, etj. Të gjeturat e këtij hulumtimi raportohen në nivel vendi, komune dhe regjioni. Hulumtimi po ashtu ka për qëllim që sipas nevojës, të mbështesë direkt nxënësit pjesëmarrës rreth orientim në karrierë.

Këtë vit, “Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë” është zbatuar në 29 komuna të Kosovës me rreth 10,000 maturantë nga 65 shkolla profesionale. Maturantët i takojnë vitit shkollor 2019/2020.

Ky raport është përpiluar për Komunën e Pejës dhe raporton hulumtimin dhe gjetjet për këtë komunë.

Fjala e Drejtorisë Komunale të Arsimit

Mbështetja e nxënësve për tranzicionin e tyre është komponentë e rëndësishme për Drejtorinë Komunale të Arsimit, qoftë ky vazhdimi i studimeve, apo kyçja në treg të punës. Për këtë arsye, Drejtoria e Arsimit mbështet realizimin e hulumtimit me maturantë të shkollave të mesme të larta, i quajtur “Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë”. Gjetjet nga ky hulumtim janë të rëndësishme për DKA-në, shkollat dhe politik-bërjen në përgjithësi, duke qenë se na informojnë për tendencat e maturantëve, interesat dhe përgatitjen e tyre, e po ashtu pikëpamjet e tyre sa i përket perspektivës që iu ofrohet në komunë lidhur me punësim pas përfundimit të shkollës së mesme të lartë. Për më shumë, gjetjet na ndihmojnë në identifikim të nevojave të nxënësve dhe rrjedhimisht marrje të vendimeve që mbështesin shkollat në përmbushje të objektivave që kanë të bëjnë me orientimin në karrierë dhe aftësim të nxënësve.

Mirënjohje

KCDF shpreh mirënjohje dhe falënderon për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre të vlefshëm në realizim të pyetësorit me maturantë, zyrtarët nga shkollat e përzgjedhura, siç janë:

- Shkolla e Mesme Teknike Shaban Spahija - Drejtori Arben Gjokolli dhe mësimdhënësi Mustafë Ukaj
- Shkolla e Artit Odhise Paskali - Drejtori Bujar Kelmendi dhe Sekretarin Besmir Nikqi
- Shkolla e Muzikës Halit Kasapollu - Drejtoresha Zamirë Selimi dhe Sekretarin Besmir Nikqi
- Shkolla e Mesme Ekonomike Ali Hadri - Drejtori Arif Ademaj dhe mësimdhënësjja Anda Ethem.

Gjithashtu, KCDF vlerëson pjesëmarrjen dhe përgjigjet e secilit nxënës.

Metodologjia e hulumtimit

Dizajni i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të raportoj mbi perspektivën e maturantëve në shkollat profesionale të Kosovës rreth orientimit në karrierë dhe të ardhmen e tyre profesionale. Për këtë arsye, është dizajnuar dhe zbatuar një pyetësor për maturantë që mat konstrukte të ndryshme rreth orientimit në karrierë. Pyetësi është vetë-raportues dhe rrjedhimisht rezultatet e tij tregojnë perceptimin e nxënësve mbi shkathtësitë e tyre dhe rolin e shkollës rreth edukimit dhe orientimit në karrierë.

Instrumenti

“Barometri i Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë” përmban gjithsej 18 pyetje. Disa nga këto pyetje janë vetëm për maturantët që do të vazhdojnë studimet universitare, gjersa disa janë vetëm për maturantët që synojnë tregun e punës. Duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit, pyetjet mbulojnë këto fusha:

- Të dhënat demografike të nxënësve
- Planet profesionale pas klasës së XII-të
- Puna praktike gjatë shkollës së mesme të lartë
- Qasja në treg të punës
- Mbështetja rreth orientimit në karrierë

Pyetjet janë të formave të ndryshme. Disa pyetje janë pohime që nxënësi vlerëson nga 1 (*fuqimisht nuk pajtohem*) deri në 5 (*fuqimisht pajtohem*) se sa këto pohime janë të vërteta për ata. Për ilustrim, një pyetje e tillë është: “Puna praktike ka qenë e dobishme për avancimin tim profesional”. Pyetje të tjera përfshijnë përzgjedhjen e një opsioni. Për shembull, “Zgjidhni fushën në të cilën dëshironi të studioni?” Disa pyetje janë të hapura, p.sh. Shënoni emrin e kolegjit / universitetit në të cilin dëshironi të studioni.

Procedura e anketimit dhe çështjet etike

Hulumtimi është kryer në bashkëpunim me drejtorët e shkollave dhe koordinatorët për sigurim të cilësisë. Koordinatorët për sigurim të cilësisë e kanë shpërndarë pyetësorin në secilën paralele të klasës së XII-të, ndërsa drejtorët e shkollave e kanë monitoruar procesin dhe i kanë inkurajuar nxënësit që ta plotësojnë pyetësorin me vëmendje. Plotësimi i pyetësorit ka zgjatur mesatarisht 10 minuta.

Për shkak të qëllimit të hulumtimit, pyetësi nuk është anonimizuar. Pjesëmarrja e nxënësve në këtë hulumtim ka qenë plotësisht vullnetare dhe ndarja e të dhënave është bërë me pëlqim të nxënësve. Të dhënat janë procesuar si tërësi dhe pa ndërlidhje me identitetin e nxënësve.

Mostra

Pjesëmarrës nga Komuna e Pejës ishin në total 484 maturantë të katër shkollave, SHMM Halit Kasapollit (N=23), SHME Ali Hadri (N=133), SHMLAA Odhise Paskali (N=81) dhe 247 SHMT Shaban Spahija. Prej këtyre nxënësve, 201 janë vajza dhe 283 djem. Nxënësit vijojnë mësimet në 32 profile të ndryshme të këtyre katër shkollave. Grafiku në vijim ilustron përbërjen e nxënësve.

Tabela 1. Profilet dhe përbërja e pjesëmarrësve.

Ali Hadri Profili	133 N	Halit Kasapolli Profili	23 N	Odhise Paskali Profili	81 N	Shaban Spahija Profili	247 N
Asistent Juridik	28	Muzikë	23	Art dhe pikturë	25	Arkitekturë	25
Banka dhe sigurime	10			Dizajn enterieri	19	Automekanikë	29
Kontabilitet	24			Dizajn grafik	12	CNC	8
Logjistikë	7			Dizajn tekstili	25	Elektronik Konsumues	11
Marketing	22			Operator prodhimi	8	Energjetikë	10
Përpunues i prodhimeve ushqimore	22					Gjeodezi	4
Prodhimtari e kulturave të përziera dhe të kafshëve	5					Informatikë	52
Shpedicion	7					Instalues Elektrik	7
Turizëm	5					Instalues ngrohjes dhe klimatizimi	24
						Instalues uji dhe kanalizim	6
						Metalpunues me saldues	4
						Ndërtimtari	12
						Tekstil	9
						Telekomunikacioni	24
						Transport rrugor	19
						Zdruktorë	3

Analizimi i të dhënave

Për analizim të të dhënave është përdorur Paketa Statistike për Shkenca Sociale (SPSS). Analizat e bëra në këtë hulumtim përfshijnë statistikë përshkuese dhe në disa raste inferenciale. Për të mos ngarkuar raportin me shumë numra, shumica e rezultateve janë rrumbullakuar në vlera të plota, pa decimale.


Rezultatet

Në vijim janë të paraqitura rezultatet në pyetjet e pyetësorit, të ndara në fushat përkatëse.

Planet profesionale dhe edukative të maurantëve pas klasës së XII-të


Maurantëve pjesëmarrës në këtë hulumtim iu është kërkuar të zgjedhin se çfarë plane kanë për të ardhmen e tyre. Pjesa më e madhe e maurantëve (64%) janë shprehur se do të vazhdojnë studimet universitare pas diplomimit të tyre nga klasa e XII-të, gjersa 21% e tyre kanë deklaruar se do të kyçen në treg të punës. Grafiku në vijim ilustron përgjigjet e nxënësve për secilën kategori.

Grafiku 1. Planet e maurantëve pas diplomimit.




Planet për të ardhmen janë analizuar edhe varësisht shkollës. Grafi në vijim ilustron planet e maturantëve që vijojnë mësimin në shkollat përkatëse.

Grafiku 2. Planet e maturantëve pas diplomimit për secilën shkollë.



Gati se të gjithë (98%) maturantët që planifikojnë të vazhdojnë studimet, kanë përzgjedhur edhe fushën e tyre të studimeve. Grafi në vijim ilustron përgjigjet e këtyre nxënësve. Fusha më e përzgjedhur nga maturantët e Pejës është *Arte dhe dizajn* (26%).

Grafiku 3. Fushat e studimit të përzgjedhura nga maturantët.




Përgjigjet e nxënësve që do të vazhdojnë studimet po ashtu janë analizuar veçmas për secilën shkollë. Nxënësit e shkollës Ali Hadri (N=89) më së shumti kanë përzgjedhur fushën e *Ekonomisë* (39%) dhe *Juridikut* (23%). Nxënësit e shkollës Halit Kasapolli (N=20) dominojnë fushën e *Arteve dhe dizajnit* (90%). Tutje, nxënësit e shkollës Odhise Paskali (N=75) po ashtu më së shumti kanë përzgjedhur fushën *Arte dhe dizajni* (72%). Në fund, nxënësit e shkollës Shaban Spahija (N=118) kanë dhënë përgjigje më të llojllojshme. Tre fushat më të përzgjedhura janë *Teknologjia e informimit dhe komunikimit* (25%), *Ndërtimtaria dhe arkitektura* (17%) si dhe *Inxhinieria elektrike dhe mekanike* (14%).

Në shtojcën 1 të këtij raporti mund të gjeni grafe që ilustrojnë ndërlidhjen mes profileve në të cilat nxënësit vijnë mësimin dhe fushave të studimit të synuara në arsimim të lartë. Secili rreth paraqet një përgjigje të nxënësit.


Maturantët që do të vijojnë studimet po ashtu janë përgjigjur në pyetjen se sa janë të vendosur se çfarë dëshirojnë të studiojnë. Siç ilustron grafi në vijim, më shumë se gjysma e tyre janë shumë të vendosur për fushën e përzgjedhur.

Grafiku 4. Vendosmëria e maturantëve që do të vazhdojnë studimet rreth fushës së tyre të studimit.



Tutje, maturantët kanë shënuar emrin e universitetit / kolegjit ku ata dëshirojnë të vazhdojnë studimet. Ndonëse kanë deklaruar se do të vazhdojnë studimet, 13% e nxënësve nuk kanë shënuar emrin e universitetit ku dëshirojnë të studiojnë. Diagrami në vijim ilustron përgjigjet e dhëna. Universitetet e zgjedhura nga më pak se 3% e maturantëve janë grumbulluar në Tjetër.

Grafiku 5. Kolegjet / Universitetet e zgjedhura nga maturantët.



Puna praktike gjatë shkollës së mesme të lartë

Katër pyetje të Barometrit kanë të bëjnë me punën praktike. Këto pyetje matin orët praktike të kryera në ndërmarrje apo kompani për secilin vit të shkollës së mesme të lartë, përgatitjen për punë praktike në kuadër të shkollimit dhe dobishmërinë e praktikës për avancimin profesional.

Nga gjithsej 457 nxënës që janë përgjigjur në pyetjen se a kanë mbajtur orë praktike, 53% janë përgjigjur me Po, ndërsa 47% kanë raportuar se nuk kanë mbajtur. Mbajtja e punës praktike ka ndryshuar varësisht profilit. Prej shkollës Ali Hadri, 72% deklarojnë se kanë mbajtur punë praktike, nga shkolla Halit Kasapolli vetëm 4%, Odhise Paskali 40% dhe nga shkolla Shaban Spahija 43%.

Nxënësit po ashtu kanë raportuar orët e mbajtura të praktikës përgjatë tre viteve. Përpos nxënësve të shkollës Halit Kasapolli që nuk janë përgjigjur në këtë pyetje, nga nxënësit e tre shkollave tjera vërehet se puna praktike është kryesisht e koncentruar në klasën e XII-të. Numër i përafërt i nxënësve kanë raportuar se kanë mbajtur praktikë gjatë të tre viteve. Nxënësit e shkollës Odhise Paskali kanë dhënë përgjigje më të përafërta në orë të praktikës, gjersa maturantët e dy shkollave të tjera variojnë në numër të orëve brenda secilit vit.

Tabela në vijim paraqet të dhënat rreth orëve të praktikës për secilën shkollë dhe në total. Të dhënat përfshijnë numrin e nxënësve që kanë deklaruar orët, minimumin dhe maksimumin e orëve të raportuara, mesataren si dhe devijimin standard që përfshin largimin nga mesatarja.


Tabela 2. Të dhënat në nivel shkolle rreth orëve të punës praktikës.

Shkolla	Klasa	Numri i nxënësve	Minimumi i orëve	Maksimumi i orëve	Mesatarja e orëve	Devijimi standard
Ali Hadri	Klasa X	46	3	408	153	186
	Klasa XI	57	3	408	129	175
	Klasa XII	114	3	408	130	150
	Total	114	3	1188	256	393
Odhise Paskali	Klasa X	11	6	20	8	4
	Klasa XI	26	2	270	24	52
	Klasa XII	36	2	85	28	22
	Total	44	5	318	39	49
Shaban Spahija	Klasa X	30	5	200	52	60
	Klasa XI	38	2	200	65	54
	Klasa XII	86	4	600	123	126
	Total	86	4	600	170	155
Gjitha shkollat	Total	244	3	1188	187	295

Në shtojcën 3 të këtij raporti mund të gjeni mesataret e orëve të praktikës gjatë shkollës së mesme të lartë për secilin drejtim të katër shkollave pjesëmarrëse.

Pyetësi po ashtu përmban dy pohime që kërkojnë vlerësim të eksperiencës në punë praktike. Nxënësit që kanë mbajtur praktikë, në përgjithësi kanë vlerësuar se shkolla i ka përgatitur ata për punë praktike dhe se kjo e fundit ka qenë e dobishme për avancimin e tyre profesional.

Grafiku 6. Vlerësimi i eksperiencës me punë praktike.



Mbështetja rreth orientimit në karrierë dhe qasja në treg të punës



Kjo pjesë e pyetësorit ka të bëjë me burimet mbështetëse rreth orientimit në karrierë, ndihmën e ofruar nga shkolla rreth orientimit në karrierë, njohuritë e nxënësve në përgatitje të aplikacionit për një punë dhe dëshirës së nxënësve për informata shtesë.

Rezultatet tregojnë se mbështetjen më të madhe për orientim në karrierë nxënësit e kanë pranuar nga familja (67%). Më së shumti mbështetje nga mësimdhënësit kanë raportuar se kanë pranuar 21% e nxënësve. Grafiku 7 ilustron përgjigjet. Pjesa Tjetër përfshin përgjigje të nxënësve si: Interesi im, vetvetja e të ngjashme.

Pyetje tjetër e pyetësorit ka të bëjë me dëshirën e nxënësve për të pranuar informata rreth procedurave të pranimit në fakultet e të ngjashme. 35% e pjesëmarrësve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Prej gjysmës tjetër që janë përgjigjur, pjesa më e madhe janë të interesuar për informata, gjersa një pjesë e vogël janë përgjigjur me Jo.

Grafiku 7. Burimet mbështetëse rreth orientimit në karrierë.

Grafiku 8. Dëshira për informata.




Tutje, disa pyetje të pyetësorit kanë matur konstruktet në vijim: (1) njohuritë e nxënësve në përgatitje të aplikacionit për një punë dhe (2) ndihmën e ofruar nga shkolla rreth orientimit në karrierë.

Njohuritë e nxënësve për të përgatitur një aplikacion pune janë matur me dy pohime. Njëri pohim kërkon vlerësimin e nxënësve në shkallë të Likertit nga 1 (*fuqimisht nuk pajtohem*) deri në 5 (*fuqimisht pajtohem*) se sa ata pajtohen se dinë të përgatisin një CV, ndërsa pohimi tjetër mat se sa nxënësit pajtohen se dinë të përgatisin një Letër motivuese.

Pasi është vërtetuar statistikisht që këto dy pohime matin të njëjtin konstrukt, të dyja pohimet janë bashkuar në konstruktin për aplikacion të punës. Nga 462 maturantë që janë përgjigjur në këtë konstrukt 10% e maturantëve *fuqimisht pajtohet* se dinë të përgatisin një aplikacion për punë, 55% *pajtohen*, 13% janë *neutral*, gjersa 16% *nuk pajtohen* dhe 6% *nuk pajtohen fuqimisht*. Grafiku në vijim ilustron përgjigjet e të gjithë maturantëve në të dy pohimet veçmas. Ndërsa, në shtojcën 4 mund të gjeni rezultatet për secilën shkollë.

Grafiku 9. Njohuritë e maturantëve në përgatitje të CV-së dhe Letrës motivuese.




Rezultatet në këtë konstrukt rreth aplikimit për punë janë analizuar edhe vetëm për nxënësit që kanë deklaruar se do të kërkojnë punë (N=81). Nga këta maturantë, 7% janë *pajtuar fuqimisht*, 47% janë *pajtuar*, 14% janë *neutral*, gjersa përqindje e njëjtë nga 16% kanë përzgjedhur kategorinë *Nuk pajtohem* dhe *Fuqimisht nuk pajtohem*.

Ndihma e ofruar nga shkolla për orientim në karrierë është matur me katër pohime në shkallë të Likertit nga 1 deri në 5. Këto pyetje përfshijnë ndihmën e shkollës rreth: (1) aplikimit në punë, (2) zgjedhjes së një profesioni, (3) zgjedhjes së një drejtimi të studimit dhe (4) aftësi për profesion. Pasi është vërtetuar statistikisht se këto pohime matin të njëjtin konstrukt, ato janë bashkuar për të vlerësuar ndihmën e perceptuar nga nxënësit rreth orientimit në karrierë.


Në lidhje me ndihmën e shkollës, nxënësit relativisht shprehen të kenë pranuar një gjë të tillë ndonëse ka një numër nxënësish që janë neutral apo që nuk pajtohen me këtë. Nga 399 maturantë që janë përgjigjur në këtë pyetje, 5% fuqimisht pajtohen me konstruktin në fjalë dhe 48% pajtohen. Tutje, 28% janë deklaruar me Neutral, gjersa 15% nuk pajtohen dhe 2% fuqimisht nuk pajtohen. Megjithatë, ka disa dallime në përgjigje në pohime të këtij konstrukti të ndihmës së shkollës rreth orientimit në karrierë. Grafiku në vijim ilustron përgjigjet e maturantëve në secilin pohim.

Grafiku 10. Ndihma e shkollës rreth orientimit në karrierë.




Përpos përgatitjes rreth orientimit në karrierë, nxënësit janë përgjigjur edhe rreth tregut të punës. Ata kanë vlerësuar se sa pajtohen me pohimin që në komunën e tyre është e lehtë të gjendët një vend i punës në profesionin e tyre. Më shumë se gjysma e maturantëve, saktësisht 55% e tyre (fuqimisht) nuk pajtohen me këtë deklaratë dhe vetëm 19% (fuqimisht) pajtohen. Pjesa tjetër (26%) janë *neutral* ndaj kësaj deklarate.

Grafiku 11. Perceptimet e nxënësve mbi vendet e lira të punës në Komunën e Pejës.



Pajtueshmëria me deklaratën në fjalë ka dallime të vogla edhe varësisht profilit të shkollës. Grafiku në vijim ilustron përgjigjet veçmas për secilën shkollë.

Grafiku 12. Perceptimet e nxënësve mbi vendet e lira të punës, varësisht profilit.



Diskutim

Hulumtimi aktual raporton për tema thelbësore që prekin sektorin e edukimit dhe tregut të punës. Të gjeturat nga ky raport janë relevante për politik-bërës, zyrtarë të institucioneve, si zyrtarë nga MASH, MPMS, DKA, drejtorë e mësimdhënës, përfaqësues të bizneseve, prindër dhe nxënës. Ky raport paraqet perspektivën rreth orientimit në karrierë të 484 maturantëve nga SHME Ali Hadri, SHMM Halit Kasapolli, SHMLAA Odhise Paskali dhe SHMT Shaban Spahija në Komunën e Pejës. Pjesëmarrësit janë nxënës të një numër profileve të ndryshme. Bazuar në gjetje, raporti jep sugjerime për çështjet që duhet adresuar për maturantët e këtij viti dhe viteve pasuese me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për ta.

Ndonëse pjesëmarrësit janë nxënës të shkollave profesionale, 64% e tyre planifikojnë të vazhdojnë studimet universitare pas diplomimit. Në anën tjetër, 21% e maturantëve planifikojnë të kthehen në treg të punës. 9% e tyre planifikojnë të dalin jashtë shtetit. Këto plane mund të kenë ndërlidhje me një gjetje tjetër të këtij hulumtimi që ka të bëjë me perceptimet e maturantëve rreth vende të punës në komunën e tyre. Sipas kësaj gjetje, vetëm 19% e maturantëve (*fuqimisht*) pajtohen se në komunën e tyre është e lehtë të gjejnë një vend të punës në profesionin që duan. Përfaqësuesit e bizneseve dhe palët e tjera të përfshira duhet të shqyrtojnë vërtetësinë e perceptimeve të maturantëve mbi vendet e punës varësisht profileve të tyre, kontekstin në përgjithësi pas këtyre gjetjeve dhe të bashkëpunojnë me shkollat në adresim të faktorëve ndikues.

Ndër fushat e studimit më të përzgjedhura nga maturantët që do të vazhdojnë studimet janë *Arte dhe dizajn* (26%), *Ekonomi* (13%) dhe *Teknologji e informimit dhe komunikimit* (11%). Më shumë se gjysma (64%) e këtyre maturantëve janë deklaruar shumë të vendosur për fushën që do të studiojnë, ndonëse ka edhe nga ata që janë pak të vendosur (35%). Në përgjithësi, mes profileve aktuale të nxënësve dhe fushave të synuara ka përshtatshmëri, ndonëse ka ndonjë anashkalim. Anashkalimet nga ky trend mund të jenë pasojë e një sërë shkaktarëve, si mungesa e informatave në përzgjedhje të shkollës së mesme të lartë, vetëdijesim më i lartë për tiparet personale, mungesa e informatave rreth universiteteve, bindjet e ndryshme që kanë të bëjnë me tregun e punës e të tjera të ngjashme. Tutje, universiteti më i përzgjedhur për vazhdim të studimeve nga 41% e maturantëve është Universiteti i Prishtinës, Hasan Prishtina.

Temë tjetër e Barometrit është puna praktike. Nxënësit kanë raportuar se një gjë e tillë është praktikë në shkollën e tyre. Rezultatet tregojnë të dhënat përshkruese rreth orëve të praktikës gjatë shkollës së mesme të lartë. Nxënësit e kanë vlerësuar mjaft pozitivisht përvojën e tyre me punë praktike, ku më shumë se gjysma pajtohen se puna praktike ka qenë e dobishme për avancimin e tyre profesional dhe se aftësitë e fituara gjatë shkollimit i kanë përgatitur ata për punë praktike. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që praktika të jetë obligative për të gjithë nxënësit. Po ashtu, është e rëndësishme që puna praktike të jetë e mirë-definuar në aspekt të orëve dhe të gjithë nxënësit të përmbushin orët e detyrueshme të praktikës.

Të pyetur në lidhje me njohuritë e nxënësve në përgatitje të një aplikacioni për punë, konkretisht CV-së dhe Letrës motivuese, përgjigjet e nxënësve tregojnë se më shumë se gjysma e maturantëve vlerësojnë pozitivisht njohuritë e tyre në këtë aspekt.

Gjysma e maturantëve janë pajtuar se shkolla ka kontribuar në orientimin e tyre në karrierë, konkretisht rreth aplikimit në punë, zgjedhje të profesionit dhe drejtimit të studimeve dhe aftësisht

për profesion. Rezultatet ilustrojnë përgjigjet e nxënësve për katër pohime të këtij konstrukti. Tutje, në pyetjen se cili është burimi më i madh i mbështetjes rreth orientimit në karrierë shumica e maturantëve kanë raportuar familjen (67%). 21% e tyre kanë deklaruar mësimdhënësit.


Vendimmarrja dhe planifikimi i hapave pas diplomimit është çështje thelbësore që duhet trajtuar në kuadër të shkollës në mënyrë që pas diplomimit nxënësit të kenë një ide dhe plan veprimi. Për më shumë, bashkëpunimi me prindër sugjerohet shumë në këtë aspekt, në mënyrë që të sigurohet se në fokus është më e mira për fëmijën, se perspektiva e tij/saj po konsiderohet dhe të arrihet një konsensus mes shkollës dhe familjes mbi hapat e ardhshëm në karrierën e fëmijës.

Për më shumë, mos hezitoni të na kontaktoni përmes email-it dhe telefonit.


Shtojca

Shtojca 1. Ndërlidhja mes profileve aktuale dhe fushave të studimit për secilën shkollë.


Shkolla Ali Hadri.




Shkolla Halit Kasapoli.




Shkolla Odhise Paskali.





Shkolla Shaban Spahija.




Shtojca 2. Vendosmëria e nxënësve për fushën e studimit për secilën shkollë.




Shtojca 3. Mesatarja e orëve praktike varësisht profilit për secilën shkollë.





Shtojca 4. Pajtueshmëria me konstruktin për përgatitje të aplikacionit për punë për secilën shkollë.



Shtojca 5. Pajtueshmëria me konstruktin për ndihmën e shkollës rreth orientimit në karrierë për secilën shkollë.

